



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 92

**Tiranë – E hënë, 14 qershor 2021**

## PËRMBAJTJA

|                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Faqe |
|-----------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 13094, datë 8.6.2021                | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....                                                                                                                                                                                                                                                    | 9229 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 320, datë 2.6.2021      | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 881, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj” ..... | 9229 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 343, datë 9.6.2021      | Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘17 Shkurti’, Qesarakë” .....                                                                                                         | 9230 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 344, datë 9.6.2021      | Për dhënien e bursave, për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “ <i>Peter Mahringer</i> ”, Shkodër, për vitin shkollor 2021–2022.....                                                                                                                                                          | 9231 |
| Urdhër i ministrit të Drejtësisë<br>nr. 372, datë 11.6.2021     | Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.....                                                                                                                                                 | 9232 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 127, datë 27.5.2021 | Mbi kërkesën e OSSH sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021, “Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2021” .....     | 9234 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 27.5.2021 | Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 24, datë 21.1.2021, mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID-19.....                                             | 9236 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 27.5.2021 | Mbi mosfillimin e procedurës për transferimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. te shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.....                                                                                 | 9238 |

|                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                   |      |
|-------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Njoftim i Ministrisë për Evropën<br>dhe Punët e Jashtme nr. 7048,<br>datë 10.6.2021 | Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....                                                                                                                                                                                        | 9239 |
|                                                                                     | Korrigjim gabimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë<br>4.5.2021, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me<br>rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.1.2021”, botuar në<br>Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 1.6.2021..... | 9239 |

**DEKRET****Nr. 13094, datë 8.6.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Dhurata Haki Hoxha
2. Eneida Petrit Mulgeci (Imeraj)
3. Joris Arjan Mulgeci
4. Aura Arjan Mulgeci
5. Blenard Filip Llambro

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**  
**Ilir Meta**

**VENDIM****Nr. 320, datë 2.6.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 881, DATË 28.10.2020,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË  
AKADEMISË SË SIGURISË, SI  
INSTITUCION I VETËM PUBLIK I  
ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E  
RENDIT E TË SIGURISË PUBLIKE, SI  
DHE ORGANIZIMIN E  
FUNKSIONIMIT E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar; të neneve 17, pika 5, dhe 30, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe

kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 881, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Akademia e Sigurisë është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, së cilës i jepet status i veçantë.”.

2. Shkronja “P”, e pikës 5, shfuqizohet.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i Akademisë së Sigurisë, i cili garanton përmbushjen e misionit të këtij institucioni dhe mbarëvajtjen financiare e administrative të tij. Ky bord përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Tre anëtarë, përzgjidhen nga Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë, tre anëtarë nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili propozon kandidatët për anëtarë të bordit pasi ka marrë dakordësinë paraprake të ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe të një anëtari nga ministri përgjegjës për rendin e sigurinë publike, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

4. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, karakterizohet në profesorë, lektorë, asistent-lektorë. Për personelin akademik me gradë policore ose gradë sipas statutit të strukturave përfituese, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet ekuivalentimi i këtyre gradave me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.

Personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe emërohet nga Rektori, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese përzgjidhet nga radhët e



punonjësve të këtyre strukturave, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe emërohet nga Rektori me propozim të titullarëve të strukturave përfituese, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të Akademisë së Sigurisë dhe titullarit të strukturave përfituese.”

5. Në pikën 20, pas fjalëve “... funksionet organike ...” shtohen “... me kohë të pjesshme ...”.

6. Në pikën 22, emërtimi “Bordi Këshillues i Akademisë së Sigurisë” zëvendësohet me “Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë”.

7. Në pikën 23, fjalët “... nga Bordi Këshillues i AS-së dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik ...” zëvendësohen me “... miratohen nga Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë ...”.

8. Në pikën 24 hiqen fjalët “... me propozim të Bordit Këshillues të Akademisë së Sigurisë ...”.

9. Pika 29 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“29. Akademia e Sigurisë financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.”.

10. Pika 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“30. Struktura dhe organika e Akademisë së Sigurisë miratohen para fillimit të vitit akademik nga ministri i Brendshëm, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në dakordësi me strukturat përfituese. Kjo strukturë organike nuk mund të ndryshohet pa përfunduar viti akademik.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

## VENDIM

Nr. 343, datë 9.6.2021

### **PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9- VJEÇARE ‘17 SHKURTI’, QESARAKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘17 Shkurti’, Qesarakë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 68 028 704 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e katër) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen është 68 028 704 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e katër) lekë dhe do të përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt



shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT "NDËRTIMI I SHKOLLËS 9 VJEÇARE "17 SHKURTIT", QESARAKË".

| Nr.   | Emër Atësi Mbledhës               | Lloji i pasurisë | Z. K. | Nr. pasurisë | Sip. Totale Truall (m <sup>2</sup> ) | Sip. prekur Truall (m <sup>2</sup> ) | Çmimi për Truall (lekë/m <sup>2</sup> ) | Sip. Totale Objekt (m <sup>2</sup> ) | Sip. e prekur Objekt (m <sup>2</sup> ) | ÇMIMI për Objekt (lekë/m <sup>2</sup> ) | VLERË (truall i prekur) (lekë) | VLERË (objekt i prekur barim) (lekë) | VLERË e Përgj. truall + objekt (lekë) | KONFIRMIM ASH K TIRANË                                     | Shënime në kartatë                                                                                                                                                                           |
|-------|-----------------------------------|------------------|-------|--------------|--------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------------------|--------------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1     | Bashkëpronarëve Lika, Shabani etj | Truall           | 8170  | 3/179        | 2,065.00                             | 1883                                 | 32878                                   | 765.6                                | 368                                    | 16628.886                               | 61909274                       | 6119429.97                           | 68028704                              | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 12329/1, datë 20.01.2021 | Vendosje e Barres Hipotekore në favor të Shtetit Shqiptar Urdhër kufizim veprimesh nga gjykata i pjesëm për pjesën e ish magazinës dhe sip. truall 135m2. Vendoset Barre Hipotekore nga DPTT |
| SHUMA |                                   |                  |       |              |                                      | 3,538                                |                                         |                                      |                                        |                                         |                                |                                      | 68,028,704                            |                                                            |                                                                                                                                                                                              |

## VENDIM

Nr. 344, datë 9.6.2021

### PËR DHËNIEN E BURSIVE, PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "PETER MAHRINGER", SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 39, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Dhënie, nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit

për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi, për nxënësit e viteve përgatitore, dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi, për nxënësit nga viti i parë deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", për vitin shkollor 2021–2022.

2. Vlera vjetore e bursës do të jetë 95 600 (nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës/prind/përfaqësues ligjor të nxënësve përfitues.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas përzgjedhjes mbi bazën e kriterëve ekonomike, si dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin



përkatës në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në Shkodër, i cili, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pa efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**URDHËR**  
**Nr. 372, datë 11.6.2021**

**PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR  
PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË  
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA  
COVID-19, NË INSTITUCIONET E  
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE  
PENALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 9, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, nenit 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”,

DUKE QENË SE:

I. Me urdhrin nr. 156/2, datë 11.3.2020, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka shpallur gjendjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19 dhe gjendja e epidemisë, për shkak të këtij infeksioni vazhdon të ekzistojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

II. Këshilli i Ministrave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Komiteti i Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga COVID-19 kanë marrë masa të jashtëzakonshme për të parandaluar përhapjen në masë të këtij infeksioni në Shqipëri;

III. Në të njëjtën linjë, Ministria e Drejtësisë ka marrë masa të veçanta për parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale. Sidoqoftë, për shkak të hapësirave të kufizuara dhe pamundësisë për të zbatuar të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19, në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale, ka një rrezik të lartë të përhapjes së shpejtë të këtij infeksioni ndërmjet të burgosurve dhe paraburgosurve;

IV. Për këtë qëllim, me urdhrat nr. 91 dhe 92, datë 9.3.2020, të Ministrisë së Drejtësisë janë vendosur masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit në drejtorinë e përgjithshme të burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

V. Në kushtet kur shkalla e infeksioneve të shkaktuara nga COVID-19 ka pësuar një rënie të ndjeshme, si rrjedhojë e ndërmarrjes së masave efektive për të parandaluar përhapjen e epidemisë nga Këshilli i Ministrave dhe zbatimit me korrektësi të tyre nga ana e qytetarëve;

VI. Si dhe, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të të burgosurve, si dhe të personelit që ushtron detyrën pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, duke mbajtur në konsideratë gjendjen aktuale të epidemisë në vend,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet të ekzekutimit të vendimeve penale (në vijim “institucionet”) të marrin masat si më poshtë vijon:

a) të burgosurit e sapoardhur në institucion të mbahen nën mbikëqyrje, në ambiente të ndara nga të burgosurit e tjerë, për një periudhë 14-ditore (katërmbëdhjetëditor);

b) stafi mjekësor i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, të marrin masat e nevojshme për të garantuar, përmes protokolleve shëndetësore të miratuara, kontrollin mjekësor të personave që hyjnë apo janë të akomoduar në institucion;

c) stafi mjekësor i institucionit të marrë masa të shtuara për personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit, në veçanti në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve;



ç) strukturat e shërbimit 24-orësh (njëzetekatërorësh), të raportojnë pranë Task Forcës së ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për çdo rast apo situatë të dyshuar për infeksion të shkaktuar nga COVID-19;

d) garantimin, jo më pak se 4 (katër) herë në muaj, të komunikimit telefonik dhe të alternativave të tjera të komunikimit elektronik të të burgosurit me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët;

dh) shmangien e grumbullimeve të të burgosurve, kur nuk është e mundur, që të respektohet ruajtja e distancës së sigurisë prej të paktën 1 (një) m nga njëri-tjetri;

e) pezullimin e dhënies së lejes shpërblyese për të dënuarit;

ë) zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta kulturore, çlodhëse dhe sportive në ambientet e institucioneve, duke respektuar distancën e sigurisë dhe rregullat e tjera anti-COVID-19;

f) kufizimin e vizitave të të burgosurit me anëtarët e familjes dhe të afërm të tjerë, në jo më shumë se 2 (dy) persona, duke respektuar distancën e sigurisë dhe rregullat e tjera anti-COVID-19, sipas specifikimeve të mëposhtme:

i. të burgosurit meshkuj dhe femra kanë të drejtën e vizitës 1 (një) herë në muaj, duke garantuar higjienën e nevojshme, kontrollin shëndetësor gjatë hyrjes, kontrollin e pasjes nga ana e vizitorit të vërtetimit nga autoritetet shëndetësore përkatëse ose analizës/dëshmisë serologjike mbi shërimin rishtazi nga COVID-19, testit të vlefshëm negativ nga infektimi me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 ose vërtetimit/dëshmisë së vaksinimit të plotë anti-COVID-19;

ii. i burgosuri i mitur ka të drejtën e vizitës 4 (katër) herë në muaj, duke garantuar higjienën e nevojshme, kontrollin shëndetësor gjatë hyrjes, kontrollin e pasjes nga ana e vizitorit të vërtetimit nga autoritetet shëndetësore përkatëse ose analizës/dëshmisë serologjike mbi shërimin rishtazi nga COVID-19, testit të vlefshëm negativ nga infektimi me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 ose vërtetimit/dëshmisë së vaksinimit të plotë anti-COVID-19;

g) pezullimin e lejes së veçantë, me përjashtim të lejes së veçantë në rast të vdekjes së anëtarëve të familjes;

gj) takimi i të burgosurit me mbrojtësin e tij ligjor të kryhet duke respektuar distancën e sigurisë dhe rregullat e tjera anti-COVID-19.

2. Personeli i institucionit të marrë masa për njohjen dhe zbatimin e protokolleve shëndetësore anti-COVID-19 të miratuara nga personat e burgosur.

3. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ushtron funksionet Task Forca, me përfshirjen e ekspertëve të shëndetësisë, për inspektimin e të gjitha institucioneve mbi marrjen dhe zbatimin e masave anti-COVID-19, sipas protokolleve të miratuara shëndetësore. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Task Forcës, si dhe strukturat përgjegjëse, në shërbim 24-orësh, që kanë detyrimin për të raportuar për çdo rast ose situatë të dyshuar për infeksion të shkaktuar nga COVID-19, kryhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Task Forca, si dhe të gjitha strukturat përgjegjëse në sistemin e burgjeve raportojnë në mënyrë periodike, çdo ditë në orën 16:00, pranë Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij urdhri, si dhe të situatës në sistemin e burgjeve në përgjithësi.

5. Kufizimet e të drejtave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve, sipas parashikimeve të këtij urdhri zgjasin deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por në çdo rast, masat e posaçme të parashikuara në të, rishqyrtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, jo më vonë se 30 ditë, mbi nevojën dhe përshtatshmërinë e çdo mase. Në përfundim të këtij afati, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i propozon ministrit të Drejtësisë ndryshimin ose mbajtjen në fuqi të këtyre masave, sipas gjendjes dhe rrezikut të përhapjes së infeksionit COVID-19 në sistemin penitenciar.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 91, datë 9.3.2020, i ministrit të Drejtësisë, “Për marrjen e masave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, i ndryshuar dhe urdhri nr. 92, datë 9.3.2020, “Për marrjen e masave në



DPB dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me datë 14.6.2021.

MINISTËR I DREJTËSISË  
Etilda Gjona (Saliu)

**VENDIM**  
**Nr. 127, datë 27.5.2021**

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, PËR  
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT  
TË ERE-s NR. 97, DATË 7.4.2021, “MBI  
MIRATIMIN E TREGUESVE PËR  
KRITERET STANDARDE TË CILËSISË  
SË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT DHE  
TË PERFORMANCËS SË SIGURISË SË  
RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE,  
PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, 16 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017; Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 76/1 prot., datë 21.5.2021, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Standardeve, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021, ‘Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2021’”,

konstatoi se:

- OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3715/1 prot., datë 23.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 607/1 prot., datë 26.4.2021, ka parashtruar kërkesën për rishikim të vendimit të Bordit të

ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021, “Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2021”.

OSSH sh.a., në shkresën sipërcituar, kërkon nga ERE:

- Ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97/2021, dhe tabelën bashkëlidhur, sipas të dhënave të shkresës nr. 9626/3 prot., datë 1.4.2021;

- Ndryshimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97/2021, për të reflektuar aprovimin paraprak të procedurave të regjistrimit, përpunimit dhe prezantimit të treguesve të cilësisë, si dhe proceset e testimit, për një periudhë 3-vjeçare, pa efekte financiare të këtyre metodologjive.

- Lidhur me kërkesën e bërë nga OSSH sh.a., si më sipër parashtruar, vlerësohet si vijon:

I. Detyrimi ligjor për miratimin e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ka lindur që në vitin 2015 me miratimin e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Në vijim, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s ka miratuar “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, duke plotësuar kështu kuadrin nënligjor në këtë fushë.

II. Periudha nga miratimi i ligjit nr. 34/2015 deri në hyrjen në fuqi të treguesve të shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të vlerësohet një kohë e mjaftueshme për të ndërmarrë gjithë hapat e nevojshme nga ana e OSSH sh.a., me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Në përcaktimin e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, me vendimin nr. 97/2021, ERE është bazuar në 3 (tre) elemente kryesor: 1. Standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të përcaktuar në akte të tjera të miratuara nga Bordi i ERE-s ndër vite; 2. Raportimin e bërë nga OSSH sh.a. në ERE,



nëpërmjet shkresave zyrtare; dhe 3. Vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, të Bordit të ERE-s, për miratimin e treguesve dhe kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

- Sikurse evidentuar, në vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, dhe në relacionin e përgatitur për këtë vendimmarrje me nr. 40/9 prot., datë 2.4.2021, rezulton se janë marrë në shqyrtim baza ligjore, vendimet e Bordit të ERE-s, si dhe komunikimet shkresore të bëra nga ana e OSSH sh.a. dhe përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndër të tjera, evidentohet si më poshtë vijon:

- Shkresa nr. 133 prot., datë 7.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1264, datë 11.12.2020, e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë;

- Shkresa e përbashkët me numra respektivë protokoll nr. 3, dhe nr. 140, datë 10.2.2020, të protokolluar në ERE me nr. 296, datë 11.2.2021, të Shoqatës Shqiptare të furnizuesve të energjisë elektrike (AAES), së bashku me Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë;

- Seanca dëgjimore e zhvilluar në datën 25.1.2021, ndërmjet OSSH sh.a. dhe palëve të interesit;

- Shkresa e OSSH sh.a., dërguar në ERE në adresën zyrtare të email-it: [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), të protokolluar me nr. 432, datë 8.3.2021;

- Shkresa e OSSH sh.a. nr. 9626/2 prot., datë 19.1.2021, protokolluar në ERE me nr. 133, datë 27.1.2021;

- Shkresa e OSSH sh.a. me nr. 609/1 prot., datë 25.1.2021, me lëndë “Lidhur me raportimin e treguesve të cilësisë së shërbimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes”;

- Shkresa e OSSH sh.a. me nr. 9626/3 prot., datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 523, datë 6.4.2021, “Lidhur me treguesit e cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike”, vlerësojmë se parashtrimet e shoqërisë janë marrë në konsideratë dhe trajtuar në procedurën përkatëse lidhur me këtë vendimmarrje;

- Shkresa e OSSH sh.a. nr. 1519/1 prot., datë 24.1.2021;

- Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe raportimet e bëra nga OSSH sh.a., të cilat janë pasqyruar në raportet vjetore të ERE-s, “Mbi gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s”.

- Në zbatim të vendimit të ERE-s nr. 175, datë 14.11.2019, “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, OSSH sh.a. ka kryer studimin “Për realizimin e treguesve të performancës së vazhdueshmërisë së furnizimit, përmirësimin gjatë viteve dhe analizën e plotë për periudhën 2015 – pritishtëritë 2020”, i cili është paraqitur në ERE me shkresën nr. 9626/2 prot., datë 19.1.2021 dhe protokolluar në ERE me nr. 133, datë 27.1.2021. Ky studim është analizuar në mënyrë shteruese në procesin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në vendimin nr. 97, datë 7.4.2021.

- Veç sa më sipër, OSSH sh.a. parashtron se deri më tani mungon një metodologji e përbashkët dhe e miratuar nga ERE për mbledhjen, përpunimin, prezantimin e të dhënave për treguesit e cilësisë, si dhe metodologjia e mënyrës së kompensimit të klientëve të energjisë elektrike, dhe treguesit ku do të bazohen këto llogaritje.

- Lidhur me këto parashtrime të bëra nga ana e OSSH sh.a. nuk ka asnjë referencë ligjore si në ligjin 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ashtu dhe në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”. Mbledhja e të dhënave është çështje operacionale, e cila realizohet nga operatorët respektiv, dhe si çdo e dhënë tjetër që mbledhet nga operatorët, mbledhen dhe të dhënat për treguesit e cilësisë. Realizimi i detyrimeve operacionale, ku përfshihet dhe mbledhja e të dhënave është detyrë e operatorit të rrjetit, në rastin konkret e OSSH sh.a., si pjesë e detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Lidhur me kompensimin e klientëve, “Rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181/2017, e parashikon këtë proces në dy nene, respektivisht në nenin 9 dhe nenin 10. Këto dy nene përcaktojnë të dy rastet e kompensimit, si atë të kompensimit të furnizuesit (neni 9) dhe atë të kompensimit të klientit fundor (neni 10). Në këto



kushte, rregullorja e miratuar me vendimin e Bordit nr. 181/2017, e ka të trajtuar këtë proces, dhe pretendimi i OSSH sh.a. mbi mosrealizimin e kompensimit të klientëve fundorë nuk qëndron.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së OSSH sh.a., “Për rishikim e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021, ‘Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2021’”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 128, datë 27.5.2021

#### **MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 21.1.2021, MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR ME PËRDORIMIN E VLERAVE ZËVENDËSUESE TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËRGJATË PERIUDHËS SË ZBATIMIT TË MASAVE PARANDALUESE NDAJ COVID-19**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.

76/4 prot., datë 24.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 25.1.2021, vendosi të miratojë kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID-19.

- Në detyrat e lëna nga vendimi nr. 24/2021, mes të tjerave, përcaktohet se OSSH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) duhet të raportojnë brenda datës 20 të çdo muaji kalendarik përgjatë kohëzgjatjes së këtij vendimi, në lidhje me ecurinë e zbatimit të tij.

- Në përgjigje të këtij detyrimi FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a., me shkresën nr. 1518 prot., datë 2.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 305/1 prot., datë 4.3.2021 kanë bërë me dije se, gjatë muajit të parë të zbatimit të vendimit të ERE-s nr. 24/2021, për shkak të pamundësive teknike dhe kohës, ka mundur të faturojë me vlera referuese zëvendësuese vetëm një pjesë të klientëve, përkatësisht 200.000 të tillë.

- Pas marrjes dijeni në lidhje me këtë raportim, ERE i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., dhe OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 305/3 prot., datë 26.3.2021 duke i kërkuar që në informacionin e radhës për muajin mars, në zbatim të pikave 11 dhe 12, të vendimit, sipërcituar, të paraqesin, gjithashtu, informacionin shterues, në lidhje me zonat (duke përfshirë, por pa u kufizuar në qytet dhe fshat), që janë faturoar me vlerë referuese zëvendësuese gjatë muajit shkurt.

- Shoqëria OSSH sh.a., përmes shkresës nr. 305/6 prot., të datës 28.4.2021, ka bërë me dije se, gjatë muajit shkurt janë faturoar me vlerë referuese zëvendësuese 175.517 klientë ose 14% e bazës totale të klientëve. Gjatë ciklit të leximit të muajit mars 2021 ishin planifikuar të faturoheshin me vlera referuese zëvendësuese 216,844 konsumatorë. Shoqëria OSSH sh.a., gjithashtu, në shkresën sipërcituar shprehet, se: “e ka të pamundur faturimin total të numrit të klientëve me vlerë referuese, numër i cili parashikohej të ishte i ndarë në 50%, sipas klientëve në çdo muaj, siç parashikuar në pikën 2.1, të vendimit nr. 24/2021”.



- Shoqëria FSHU sh.a., përmes shkresës nr. 3156/1 prot., datë 30.3.2021, protokolluar me nr. 305/3, datë 1.4.2021, ka bërë me dije se gjatë muajit janar 2021 janë regjistruar 303 ankesa në total për faturimin me vlerë referuese zëvendësuese, ndërkohë që për muajin shkurt 2021 është regjistruar vetëm 1 ankesë.

- Numri ndjeshëm në zbritje i ankesave të regjistruara në FSHU sh.a., për faturimin me vlerë referuese zëvendësuese, u has edhe gjatë implementimit të një vendimi të Bordit të ERE-s me modalitete të ngjashme faturimi, siç është ai nr. 58, datë 26.3.2020, “Mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 24.3.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar si dhe VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

- Në ERE nuk rezulton të ketë ardhur asnjë ankesë për vlerat referuese zëvendësuese gjatë kohëzgjatjes së efekteve të vendimit të ERE-s nr. 24/2021.

- ERE më anë të shkresës nr. 632, datë 28.4.2021, i ka kërkuar shoqërive informacion, në lidhje me:

1. Numrin e klientëve të energjisë që janë faturuar me vlera referuese për muajin mars;

2. Informacion në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 24/2021, sa i përket aplikimit të vlerave referuese në muaj të alternuar për të njëjtën bazë klientësh;

3. Numrin total të klientëve të energjisë elektrike që janë furnizuar gjatë muajit mars;

4. Numrin e ankesave të regjistruara gjatë muajit mars, si dhe afatet procedurale të trajtimit të tyre, së bashku me dokumentacionin mbështetës.

- OSSH sh.a. ka përcjellë në ERE informacionin e kërkuar në mënyrë tabelore dhe sqaruese, në lidhje me bazën e klientëve të faturuar me vlera referuese zëvendësuese sipas zonave.

- Nga analizimi i sa bërë me dije nga dy shoqëritë, ERE vlerësoi se shoqëritë e licencuara, subjekte të zbatimit të vendimit nr. 24/2021, e kanë të vështirë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 2.1 të tij, për shkak të

pamundësisë teknike për të gjeneruar të dhëna në kohë reale nga sistemi i përdorur për këtë qëllim.

- Azhurnimi i sistemit elektronik të të dhënave historike do të kërkonte një kohë më të gjatë se vetë afatet e shtrirjes së efekteve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 21/2021, që përfundojnë në muajin qershor 2021.

- Me marrjen e masave të qeverisë shqiptare për vaksinimin e popullatës, si dhe uljen në mënyrë të ndjeshme të të dhënave të publikuara nga “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” të numrit të të infektuarve me COVID-19 gjatë muajve të fundit, rreziku i ekspozimit ndaj tij, çka përbënte shkak kryesor për pranimin e kërkesës së OSSH sh.a. për miratimin e leximit 2-mujor, është ulur ndjeshëm.

- Në nenin 113, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj”. Ndërkohë pika 2, e po këtij neni, shprehet se “...shfuqizimi i aktit administrativ ka pasojë vetëm për të ardhmen”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 24, datë 21.1.2021, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID-19”.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe palët e interesit në lidhje me vendimin e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



## VENDIM

Nr. 129, datë 27.5.2021

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS  
PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË  
VEPRIMTARISË SË PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR HEC  
LUSEN 1, 2, 3, NGA SHOQËRIA  
“EUROBIZNES” SHPK TE SHOQËRIA  
“ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe të nenit 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, miratuar ndryshimet me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215/2019; dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 76/3 prot., datë 24.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për “Mosfillimin e procedurës për transferimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria ‘Eurobiznes’ sh.p.k. te shoqëria ‘Ete-Grup-Teknologji’ sh.p.k.”, konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 675 prot., datë 18.5.2021, shoqëritë “Eurobiznes” sh.p.k. dhe “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k., në cilësinë e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, bashkim ky me shoqëri kryesuese “Eurobiznes” sh.p.k. (pajisur nga ERE me licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 385, seria PV17K), kanë paraqitur kërkesën për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. te shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.

- Kërkesa për transferimin e licencës nga shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. te shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k., vjen për arsye se shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. ushtron aktivitete të tjera tregtare dhe shoqëria “Ete-Grup-Teknologji”

sh.p.k. nuk do të ushtrojë aktivitete tjetër përveç prodhimit të energjisë elektrike.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 891/2 prot., datë 23.3.2021, shprehet se: “...konstatojmë se licenca në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lusen 1, 2, 3, është lëshuar në emër të njërit prej anëtarëve të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive ‘Eurobiznes’ sh.p.k. dhe ‘Ete-Grup-Teknologji’ sh.p.k. Për sa më sipër, ju informojmë se MIE nuk mund të shprehet lidhur me ndryshimin e mbajtësit të licencës, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lusen 1, 2, 3, nuk është parashikuar miratimi nga ana e MIE-s për zëvendësimin e kërkuar nga ana juaj”.

- Në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) rezulton se, shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k., në objektin e veprimtarisë së saj ka edhe aktivitete të tjera përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Pra, sa pasqyruar në QKB bie ndesh me sa deklaruar vetë nga shoqëria, e cila thotë se nuk do të ushtrojë aktivitete tjetër përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Përveç sa më sipër, nga QKB-ja rezulton se shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k. është me status “Pezulluar”.

- Evidentohet se nuk është kryer pagesa e aplikimit në llogari të ERE-s për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 8, pika 2, i cili citon se: “Aplikuesi duhet të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje”, dhe si e tillë, dokumentacioni i depozituar si me poshtë nuk merret në shqyrtim nga ERE:

- Marrëveshje midis shoqërive “Eurobiznes” sh.p.k. dhe “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k., datë 10.5.2021;

- Vendim i Ortakut të vetëm të shoqërisë “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.;

- Informacion në lidhje me transferimin e licencës së ERE-s dhe formati i aplikimit të shoqërisë “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 385, seria PV17K, në veprimtarinë e



prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. te shoqëria “Ete-Grup-Teknologji” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqëritë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**NJOFTIM**  
**Nr. 7048, datë 10.6.2021**

### **MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Sulltanatit të Omanit, për heqjen e regjimit të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, nënshkruar në Riad, më 31.3.2021, ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2021.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I  
MINISTRISË PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME  
Armand Skapi

### **KORRIGJIM GABIMI**

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 4.5.2021, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.1.2021”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 1.6.2021, bëhen korrigjimet e gabimeve si më poshtë:

- Titulli i vendimit bëhet:

- “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë **25.2.2021**”.

- Paragrafi i parë i vendimit bëhet:

“Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019; të neneve 15, pika 1, dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 3.5.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë **25.2.2021**.”





*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë